

# Ndriçoje Botën me Dashuri

për Fëmijët

2021

Këtë Krishtlindje, ndiqe shembullin e Jezu Krishtit për ta ndihmuar dikë që të ndiejë se e duan, e përfshijnë dhe se të tjerët interesohen për të. Qoftë nëse është një pjesëtar i familjes, një mik, një fqinj, apo dikush që nuk e ke takuar kurrë, së bashku ne mund të marrim pjesë te nisma **#NdriçojeBotën** me dashuri. Kur ta përfundosh çdo ditë, ngjyrosi hapësirat përkatëse të numrave në faqen vijuese.



© 2021 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved.  
101 Albanian.

## NËNTOR

- 30 Jep Falas**  
Jezusi u dha të tjerëve. Jepi dikujt një buzëqeshje, qerase, jepi njërën nga lodrat e tua, ose një shërbim.

## DHJETOR

- 1 Le të Shndritë Dashuria Jote**  
Jezusi u shfaq dashuri të tjerëve. Shkruaj ose vizato tri gjëra që të pëlqejnë shumë te secili person i familjes sate. Vari listat që t'i shohë familja jote.
- 2 Dhurata e Dijetarit**  
Si të ka bekuar një burrë ose grua e ditur? Falënderoje atë për ndihmën e tij/saj.
- 3 Krishti Fëmijë**  
Lindja e Jezusit tregoi dashurinë e Perëndisë për të gjithë ne. Shih materialin e shkurtër filmik *Krishti Fëmijë: Një Histori Krishtlindjeje* me familjen tënde dhe fol rreth mënyrës se si e ndien dashurinë e Perëndisë.
- 4 Duaje të Afërmin Tënd**  
Jezusi na mësoi t'i duam njerëzit që kemi përreth. Me familjen tënde, vizito një fqinj/ë dhe njihe më mirë atë.
- 5 Ndhimë nga Agjërimi**  
Agjëro siç bëri Jezusi. Nëse je në gjendje, rri pa ngrënë një ose dy vakte dhe thuaj familjes sate të dhurojë para për bamirësi nga ato vakte. Bisedo me një njeri të dashur rreth mënyrës se si agjërimi ashtu siç bëri Jezusi mund të na forcojë ne dhe të tjerët.
- 6 Kujtesa Magjike**  
Mendo rreth një kujtimi të parapëlqyer nga Krishtlindja që të ndihmoi të kujtoje Jezusin. Bëj një vizatim të tij ose gjej një fotografi. Tregoja fotografinë/vizatimin familjes sate. Thuaju atyre pse ai kujtim është i veçantë për ty.
- 7 Kujdesi Shëndetësor**  
Jezusi u kujdes për të tjerët. Falënderoje dikë që është kujdesur për ty këtë vit.
- 8 Vëmendja e Plotë**  
Jezusi i dëgjonte njerëzit kur ata flasin. Kur njerëzit të flasin me ty sot, përpiku t'i vështrosh në sy.

- 9 Ndriçoje Pemën Familjare**  
Nderoji pjesëtarët e familjes sate që jetuan përpara se të lindesh ti. Mëso diçka të re rreth dikujt nga historia jote familjare.
- 10 Koha e Shfaqjes**  
Jezusi i përfshiu të tjerët. Gjej dikë në shkollë që është i/e vetmuar ose ka nevojë për një shok/shoqe. Ftoje atë të bashkohet me familjen tënde për një koncert, shfaqje teatrale ose ngjarje tjetër rreth Krishtlindjes.
- 11 Recetë Gatimi për t'u Gëzuar**  
Jezusi foli me shumë njerëz ndërkohë që hante me ta. Ndërsa ha sot, mëso diçka të re rreth secilit person me të cilin po ha.
- 12 Ruaj një Ndenjëse**  
Fto një shok/shoqe ose pjesëtar të familjes që të vijë në Kishë me ty këtë të diel, më 19 dhjetor, për të dëgjuar mesazhe rreth Jezu Krishtit.
- 13 Dhurata e Lutjes**  
Jezusi iu lut Atit të Tij. Gjunjzohu dhe lutju Atit Qiellor çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje.
- 14 Përsëndetjet gjatë Periudhës së Krishtlindjes**  
Jezusi qe mik me të gjithë. Përsëndete dikë të ri që ta ndihmosh të ndiejë se e duan.
- 15 Ylli Shndritës**  
Një yll i ri filloi të ndriçonte në botë kur Jezusi u lind. Kush është një dritë për ty? Vizato një pemë Krishtlindjeje për t'ia dhënë atij personi dhe vendose emrin e tij/saj mbi një yll në majë të pemës.
- 16 Darkat për Krishtlindje**  
Ashtu si Jezusi, ti mund t'i ushqesh të uriturit. Si familje, çojni ushqime dikujt në nevojë.
- 17 Bariu i Fshehtë**  
Barinjët e vizituan Jezusin kur Ai u lind. Barinjët u rrëfejnë udhën deleve dhe i mbrojnë ato. Falënderoje dikë që, si barinjët, ka ndihmuar për të të rrëfyer udhën për te Jezusi.
- 18 Këngë që ia Vlen t'i Shpërndajmë**  
Jezusi dhe ndjekësit e Tij kënduan himne.

Mblidhu me shokët ose njerëzit e tu të dashur për të kënduar këngë rreth Jezusit. Mund edhe t'i marrësh të tjerët në telefon për t'u kënduar atyre.

- 19 Nga Lluka 2 tek Ti**  
Lexo me rradhë me njerëz të tjerë rreth lindjes së Jezusit te Lluka 2:1-20. Mund edhe ta bëni me radhë leximin me familjen ose shokët përmes telefonit.
- 20 Koha me Njëri-Tjetrin**  
Jezusi i mblodhi njerëzit bashkë për t'u dhënë mësim dhe për t'u shërbyer. Ndhimoje familjen të mblidhet për një veprimtari nga afër ose në një bisedë përmes videos me familjarët që jetojnë larg.
- 21 Shpërndarja e Dritës**  
Jezusi dha mësim nëpërmjet historive. Tregoji dikujt një histori nga jeta jote që është e veçantë për ty. Kërkoju të tjerëve që të bëjnë të njëjtën gjë.
- 22 Dhuratat nga Perëndia**  
Ti mund të japësh falënderime siç bëri Jezusi. Mendo rreth dhuratave që të ka dhënë Perëndia, dhe shkruaji ose bëj një vizatim të tyre.
- 23 Qeras Dy Herë**  
Ndaj gjëra me të tjerët siç bëri Jezusi. Qeras dy herë. Qeras një shok/shoqe, pastaj pyete atë se kë person tjetër mund të qerasësh.
- 24 Duaji Mamin dhe Babin**  
Nderoji prindërit e tu sikurse bëri Jezusi. Shkruaju prindërit e tu (ose një figure prindërore) një pusullë ose kartolinë me gjërat që të pëlqejnë shumë tek ata.
- 25 Jezusi Është Drita e Botës**  
Krishtlindja është një kohë për të nderuar Jezu Krishtin. Tregoji dikujt një shkrim të shenjtë rreth Tij.
- 26 Ndriçoje Vitin 2022**  
Ne mund të përqendrohemi te Jezusi gjatë gjithë vitit. Teksa vendos synime te broshura Fëmijët dhe Rinia për vitin 2022, vër re si Ati Qiellor dhe Jezu Krishti mund të të ndihmojnë për synimet e tua çdo ditë. Te Libri *Udhëzues për Fëmijët* që ke, shkruaj mënyrat në të cilat Ata të bekojnë.

